



Nuk kanë të ndalur rastet e vjedhjeve në Kosovë, vetëm dje hajnat vodhën shumë telefona, kompjuterë e para

10 orë më parë
nga: **Mergim Rreci**

Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të vjedhjeve dhe një vjedhje në tentativë në Policinë e Kosovës.



Në raportin 24 orësh të PK-së, bëhet e ditur se tri vjedhje të rënda kanë ndodhur në komunën e Fushë Kosovës.

Sipas tyre, disa persona të panjohur kanë vjedhur telefonë, Ipad dhe kompjuter.

“Fsh.Vragoli, Fushë Kosovë, 15.06.2021-03:49. Ankuesi mashkull kosovar ka raportuar se katër të dyshuar, të panjohur dhe me maska, kanë depërtuar në brendi të objektit, për momentin nuk dihet se çka është vjedhur.

Rr. Nëna Terezë, Fushë Kosovë, 15.06.2021-03:52 Ankuesi mashkull kosovar ka raportuar se katër të dyshuar të panjohur me maska kanë depërtuar në brendi të objektit të ku kanë vjedh dy telefona Iphon dhe një Ipad dhe më pas janë larguar me veturë në drejtim të panjohur.

Rr Dardania, Fushë Kosovë, 15.06.2021-04:02. Ankuesi mashkull kosovar ka raportuar se katër të dyshuar të panjohur me maska kanë depërtuar në brendi të objektit, ku kanë vjedh një kompjuter dhe disa telefona celular dhe më pas janë larguar në drejtim te panjohur”, thuhet në njoftim.

Kurse në Kaçanik një grabitje kishte ndodhur në një pompë të derivateve

Një punëtor ka raportuar se një i dyshuar i panjohur nën kërcënimin e armës se ftohte-thikës i ka grabit 40 euro.

“Kaçanik, 15.06.2021- 03:50. Viktima mashkull kosovar punëtor i pompës së derivateve ka raportuar se një i dyshuar i panjohur nën kërcënimin e armës se ftohte-thikës i ka grabit 40 euro dhe është larguar ne drejtim të panjohur.

Fsh. Carralluk, Malishevë, 15.06.2021 – 17:18. Ankuesi mashkull kosovar ka raportuar se nga persona të pa njohur i është thyer vetura e tij e llojit në të cilën ka pasur një çantë të krahut në të cilën ka pasur një revole një karikator dhe 18 fishekë të njëjtit kalibër”. thuhet tutje në raport.

Kurse në Vushtrri dy persona kanë rënë në pranga pasi u kapën në flagrancë duke tentuar që të viedhin nga një veturë.

“Vushtrri, 15.06.2021-02:35. Janë arrestuar dy te dyshuar meshkuj kosovar pasi që të njëjtit janë kapur në flagrancë duke tentuar që të vjedhin nga vetura. Të dyshuarit pas intervistimit me vendi të prokurorit lirohen në procedurë të rregullt”.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMI
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO

**Njoftim nga
autoriteti i likuidimit
për parashtruesit e
kërkesave (Vendime,
kërkesa për
informata shitesë)**

Artikull i sponsorizuar

**Autoritetet e Likuidimit
(AL-të) të NSh-ve:
Përparimi (në likuidim),
Kompania e Sigurimeve
Kosova (në likuidim),
Agrokosova (në**



**Në Petrol Company
nga data 30 Qershor
– 3 Korrik dhurohen
super shpërblime:
Iphone 12, Sony
Playstation 4,
Scooter Elektrik
Smart, Pushim në
Stamboll e deri tek
Banasa në fund të
vitit**

[illegible]

Tashmë çdo muaj po ndahen shpërblime të ndryshme nga Petrol Company për klientët e sajë me anë

LAJME TJERA



12 minuta më parë

Rama takon Sarkozyn në Paris



17 minuta më parë

Policia arreston personin që hyri në emër të dikujt tjetër në testin për patentë shofer.



21 minuta më parë

Ferdonije Qerkezi
mirëpret dialogun për të
pagjeturit: Pa bisedime
asgjë nuk mund të
bëhet